



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 2 shkurt 2024

DVP Vlorë – Vihet në pranga 1 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër

Tiranë/Vihen në pranga 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale

DVP Shkodër/Vihet në pranga 5 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 2 shtetas dhe vijon puna për kapjen e 1 tjetri, autorë të dyshuar për vepra të ndryshme penale

DVP Korçë – Vihen në pranga 2 shtetas



Lajmet

02/02/2024

DVP Elbasan/Vihen Në Pranga 2 Shtetas Dhe Procedohen Në Gjendje Të Lirë 4 Të Tjerë, Për Vepra Të Ndryshme Penale

DVP Elbasan/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 4 të tjerë, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan në flagrancë shtetasit:

-A. P., 21 vjeç, banues në fshatin Bujqës, pasi në aksin rrugor “Elbasan-Cërrik”, me automjetin që drejtonte, ka përplasur automjetin me drejtues shtetasin B. N., 25 vjeç, banues në fshatin Bujqës. Si pasojë janë dëmtuar drejtuesit e 2 automjeteve dhe 2 pasagjerë, të cilët janë në spital, në kujdesin e mjekëve;

-M. C., 33 vjeç, banues në fshatin Labinot, pasi u kap duke drejtuar motomjetin, pa leje drejtimi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Elbasan referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit:

-G. D., 51 vjeç dhe O. D., 29 vjeç (babë e bir), banues në Elbasan, pasi janë konfliktuar fizikisht, për motive të dobëta, me shtetasin E. K., 39 vjeç, banues në Cërrik. Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit G. D., Policia gjeti dhe sekuestroi 1 pushkë sportive;

-A. R., 49 vjeç, banues në Elbasan, pasi duke qenë në gjendje të dehur, në lagjen “Emin Matraxhiu”, ka kanosur shtetasin A. A., me detyrë inxhinier i një firme kontraktore të Ujësjiellësit, gjatë kohës që kanë qenë duke kryer punime.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Cërrik referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin A. P., 68 vjeç, banues në Belsh, pasi ka kanosur me fjalë 65-vjeçar, për motive të dobëta.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Gramsh/Më datë 01.02.2024, është dërguar nga familjarët e saj, në spitalin e Gramshit, për kujdes mjekësor, shtetasja A. Ll., 43 vjeçe, banuese në fshatin Tunjë. Nga veprimet hetimore rezultoi se kjo shtetase ishte dëmtuar gjatë kohës që ka qenë duke krasitur pemët, në kopshtin e banesës.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për vlerësim.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Memaliaj – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër

DVP Fier – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen penalishy ▶